



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 400/01-35633 dt. 14.07. 2022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit Nr.08/L-066 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, Ligjin Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2022, të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për ndarjen e mjeteve

Neni I

Me këtë Propozim Vendim, propozohet ndarja e mjeteve nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në shumën prej 8,000.00 € nga kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfereve në Drejtorinë e Administratës së Shëndetësisë, të ndajë shumën e përcaktuar për Marrëveshjen e Partneritetit të nënshkruar në mes të Komunës së Drenasit dhe ASB (Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland) me datë 13.07.2022.

Neni II

Ndarja e mjeteve të bëhet nga kategoria e subvencioneve në administratën e shëndetësisë kod 73010, vlera prej 8,000.00 € për subvencionimin e 10 familjeve për hapjen e bizneseve të vogla familjare mbështetëse, si dhe renovimi dhe mobilimi i zyrave të OJQ HandiKos dega në Drenas.

Neni III

Ndarja e mjeteve bëhet nga burimi i financimit 22, brenda nën-programit, drejtoria e administratës së shëndetësisë me kod (73010).

Neni IV

Për zbatimin e këtij propozim vendimi kujdeset: Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Neni V

Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

A r s y e t i m

Me marrjen e këtij vendimi do të përfitojnë 10 nga 30 familje të përzgjedhuara nga ASB (Organizatë Ndërkombëtare Humanitare), të komunës së Drenasit, të cilat janë në asistencë sociale ku do ju krijohen mundësitë për fillimin e bizneseve të vogla familjare mbështetëse. Po ashtu në këtë marrëveshje përfshihet dhe subvencionimi i OJQ HandiKos duke renovuar dhe mobiluar zyret e saj. Shuma totale e kësaj Marrëveshje Partneriteti do të jetë 35,000.00€, ku ASB (Arbeiter-Samariter-Bund) do të co-financojë në këtë MP me shumën prej 27,000.00€, ndërsa Komuna e Drenasit do të co-financojë me shumën 8,000.00€. Ky projekt është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme Gjermane dhe implementohet nga Organizata Ndërkombëtare Humanitare Gjermane "Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland" ASB në Kosovë dhe Komunën e Drenasit.

Me Respekt,



REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Prantuar	13 07 2022		
Nj. Org	Numër	Chifra	Vlera
01-400/01	35149		



MARRËVESHJE PARTNERITETI

Ndërmjet:

Organizatës Ndërkombëtare Humanitare

Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland e.V.

dhe

Komunës së Drenasit

Titulli i projektit: Përkrahje Shumë-Dimensionale Socio-Ekonomike për familjet në nevojë dhe institucione në 6 komuna të Kosovës

PALËT

Ky dokument përcakton tërësinë e kësaj marrëveshjeje, ndërmjet:

1. Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland e.V. si implementues i projektit dhe
2. Komunës së Drenasit, si bashkëpunëtore e projektit

A. SFONDI DHE QËLLIMI

Ky projekt është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme Gjermane dhe implementohet nga Organizata Ndërkombëtare Humanitare Gjermane "Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland e.V." (**ASB**) në Kosovë.

Qëllimi i Projektit është të mbështesë:

Komponenti i parë: 10 familje në nevojë të komunës respektive për krijimin e kushteve më të mira për fillimin e bizneseve të vogla familjare

Komponenti i dytë: OJQ HandiKos duke renovuar dhe mobiluar zyrat

Projekti fillon më 01 Korrik 2022 dhe do të zgjasë deri më 31 Dhjetor 2022.

Gjatë kësaj periudhe kohore përfaqësuesit e projektit do të punojnë ngushtë me komunën e Drenasit, gjegjësisht me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për t'i identifikuar rastet të cilat përmbushin kriteret e përcaktuara paraprakisht nga projekti, si dhe identifikimin e nevojave të OJQ HandiKos në Drenas.

Aktivitetet e komponentit të parë përfshijnë:

- Identifikimin dhe profilizimin e 10 familjeve përfituesve potencial në territorin e komunës së Drenasit
- Përzgjedhjen e 10 familjeve përfituese të projektit
- Trajnimin e përfituesve potencial nga lista e ngushtë (5 ditë trajnim për start-up bizneset e vogla familjare).
- Përgatitjen e planeve të biznesit për përfituesit e projektit
- Shpërndarjen e pakove të qëndrueshmërisë apo granteve në formë të mjeteve/paisjeve
- Monitorimin / mbikëqyrjen e projektit

Si rrjedhojë, përfituesit e projektit duhet të plotësojnë kriteret që janë të përcaktuara si në vijim:

- Rastet e skemës sociale,
- Personat nga këto kategori që janë të gatshëm të fillojnë ndonjë biznes familjar,
- Familjarët të cilët shprehin gadishmëri për të marrë pjesë në trajnime të organizuara nga implementuesit e projektit,
- Familjarët që në të kaluarën nuk kanë përfituar kështu lloji të ndihmës nga organizatat/institucionet tjera,
- Familjet me numër më të madh të anëtarëve,
- Familjet që kanë persona me aftësi të kufizuara, si dhe
- Familjet ku femrat janë kryefamiljare etj.

Në komunën e Drenasit në total do të përfitojnë dhjetë **(10)** familje nga rexhistri i asistencës sociale, në vlerë mesatare prej **2,500 EUR** për secilën familje.

Aktivitetet e komponentës së dytë përfshijne:

- Identifikimin e nevojave prioritare të OJQ HandiKos
- Përpilimi i listës me detaje për punë dhe paisje (paramasa dhe parallogaria)
- Prokurimi i punëve të përcaktuara me paramasë dhe parallogari, si dhe sipas listës së kërkesave për paisje.
- Monitorimin / mbikëqyrjen e projektit

Për OJQ HandiKos Drenas është planifikuar buxheti rreth **10,000.00 EUR**.

Totali i përkrahjes financiare për të gjitha aktivitetet është **35,000.00 EUR (tridhejtëpesë mijë euro)**

B. PËRGJEGJËSITË E PALËVE

Palët bashkërisht do të punojnë për t'i arritur qëllimet e lartpërmendura të projektit duke u bazuar në aktivitetet e radhitura më parë. Në veçanti, palët pajtohen të ekzekutojnë aktivitetet vijuese gjatë kohëzgjatjes së projektit:

I. ASB si Implementues i Projektit do të:

1. Caktojë zyrtarët që do të vizitojnë familjet që janë identifikuar paraprakisht nga Zyra për Mirëqenie Sociale në Komunë (ZMS) si raste sociale, si dhe për përpilimin e listës së nevojave dhe kërkesave të OJQ HandiKos Drenas.
2. Projekti paraprakisht do t'i informojë zyrtarët për ditët e caktuara për vizitat në terren.
3. Projekti do të sigurojë transportin për zyrtarët e vet si dhe zyrtarët komunal për vizitë tek përfituesit potencial.
4. Projekti do të përpilojë listën kryesore bazuar në dosjen e secilës vizite (pyetësori, fotot dhe dokumentet e tjera faktike). Njëkohësisht do të përgatitë listën rezervë ku të dyja listat do t'i prezentohen ZMS-së dhe Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe si rezultat nga procesi, ASB-ja do të përpilojë dhe prezantojë listën përfundimtare të përfituesve.
5. Projekti do të angazhojë trajnerë dhe do të organizojë mbarëvajtjen e trajnimit të përfituesve të projektit;
6. Projekti do ta asistojë secilin përfitues mbi përpilimin e planit e biznesit.
7. Projekti në bashkëpunim me zyrtarë nga ZMS do ta informojë secilin përfitues për shumën e grantit të qëdrueshmërisë.
8. Projekti do t'i kryejë të gjitha procedurat për blerjen e mjeteve-paisjeve, duke u bazuar në planin e biznesit të secilit përfitues të projektit, si dhe do t'i kryejë procedurat e prokurimit për punët e përshkruara në Paramasa dhe Parallogari për OJQ HandiKos Drenas

9. Projekti do të ftojë përfaqësues të lartë komunal që së bashku me udhëheqësit e projektit në një ceremoni të bëjnë shpërndarjen e granteve të qëndrueshmërisë tek secili përfitues.
10. Projekti do të monitorojë në vazhdimësi familjet përfituese të projektit se a janë duke e zbatuar projektin bazuar në planin e tyre të biznesit si dhe bazuar në kriteret e procesit të pranim dorëzimit të pakove, si dhe do ta monitorojë ecurinë e ofrimit të shërbimeve më të mira sociale për personat me aftësi të kufizuara.

II. Komuna do të:

1. Caktojë një person apo zyrtar komunal në një pozitë me përgjegjësi dhe me influencë të mjaftueshme që të veprojë si person kontaktues kyç dhe primar për projektin brenda një jave pasi që të jetë nënshkruar marrëveshja;
2. Sigurojë projektin dhe nëpunësit e vet me të gjitha informatat dhe mbështetjen e kërkuar në lidhje me përmbushjen e qëllimeve të Projektit dhe kësaj marrëveshjeje;
3. Do të sigurojë që Komuna dhe ZMS-ja të përpilojnë listën e familjeve që i plotësojnë kriteret e lartëcekura e të cilat janë caktuar paraprakisht nga projekti,
4. OJQ HandiKos Drenas do të përpilojë listën me detaje për punë (Paramasa dhe Parallogari) dhe listën e paisjeve të nevojshme;
5. Mbështesë ekipin e projektit duke caktuar zyrtarë komunal që së bashku në terren të vizitojnë familjet e identifikuara paraprakisht si përfitues potencial dhe OJQ-në;
6. Ofrojë dokumente, informata dhe dëshmi të nevojshme për të pasuruar dosjen e kandidatëve potencial.
7. Ndihmojë zyrtarët e projektit dhe përfituesit potencial në gjetjen e ideve më të mira dhe funksionale bazuar në situatën reale në terren.
8. Ta ofrojë lokacionin se ku do të mbahet trajnimi, po që se ka në dispozicion.
9. Sigurojë pjesëmarrjen e një ose më shumë zyrtarëve udhëheqës të komunës në shpërndarjen e granteve të cilat ofrohen nga projekti.

C. BASHKËFINANCIMI

Palët e këtij MP pajtohen që ky projekt të implementohet me bashkëfinancim, vlera totale e projektit në këtë komunë do të jetë rreth 35,000.00 EUR, ku Komuna e Drenasit do të kontribuojë në projekt me shumën prej **8,000.00 EUR** (tetëmijë euro), shumë e cila do të transferohet në xhirollogarinë bankare të OJQ ASB, dhe atë jo më larg se 30 ditë pas nënshkrimit të këtij MP-i.



Të dhënat bankare të ASB-ës

Emri i Bankës: **ProCredit Bank**
Numri i llogarisë: **1120-101873-0101-16**
Bartësi i llogarisë: **ASB Arbeiter- Samariter- Bund Deutschland e.V.**

D. RAPORTIMI

ASB obligohet që në fund të projektit të përgatisë detalet e përfituesve si dhe një raport financiar me shpenzimet për secilin përfitues.

Konfidencialiteti

Konfidencialiteti i çfarëdo informatave që kanë të bëjnë me një individ apo një grup përfituesish të projektit duhet të respektohet. Përmbajtja e çfarëdo dosjeje, përfshirë bazat e kompjuterizuara të të dhënave, mund t'u jepen vetëm personave të autorizuar nga ASB-ja, dhe vetëm kur kjo është në interes të individit apo grupit në fjalë.

Anti-korrupsioni

Nuk bëhet, premtohet, kërkohet apo pranohet asnjë ofertë, pagesë, kompensim apo përfitim i çfarëdo lloji, i cili mund të konsiderohet praktikë joligjore apo korrupsion- nga asnjë prej palëve të këtij MP, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë - si nxitje apo shpërblim në lidhje me aktivitetet e financuara nga ky projekt, përfshirë tenderimin, publikimin dhe zbatimin e kontratave. Çfarëdo praktikë e tillë do të jetë bazë për anulimin e menjëhershëm të projektit dhe partneritetit, e për veprime të tilla shtesë, edhe padi civile apo penale.



E. KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES (NDRYSHIMET / NDËRPRERJA)

Kjo Marrëveshje Partneriteti do të bëhet efektiv, pas nënshkrimit nga të dyja palët. MP do të përfundojë me 31 Dhjetor 2022, por mund të amandamentohet në çdo kohë me marrëveshje reciproke, në mes të të dy palëve. Secila palë në këtë marrëveshje, mund ta ndërprejë këtë MP, duke iu ofruar njoftim me shkrim, tridhjetë (30) ditë paraprakisht, palëve të tjera nënshkruese.

Nënshkruar me datë:

Organizata Ndërkombëtare Humanitare

Komuna e Drenasit

Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland e.V

Përfaqësuar nga:

Përfaqësuar nga:

Kryesuese e Zyrës

Kryetari i Komunës

Znj: Dafina Hoxha

Z. Ramiz Lladrevci

Dafina Hoxha



Z. Ramiz Lladrevci





Për zyren e Kuvendit

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-40, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Që në vështrim të nenit 40 pika 40.2 nën b dhe c të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe në bazë të nenit 34.6 nën b dhe c të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt më dt. _____ vitit 2022 të aprovoi këtë:

**PROPOZIM VENDIM
PËR RIALOKIMIN E MJETEVE FINANCIARE NGA MBETJET E PROJEKTEVE
KAPITALE BRENDA KATEGORISE**

Neni 1.

Më këtë Propozim- Vendim, miratohet lejimi i shfrytëzimit të mjeteve financiare nga mbetjet e projekteve kapitale në Drejtoratin për Infrastruktura Lokale, kodi i programit (66310) këto kapitale për vitin 2022

Lejimi i shfrytëzimit të mbetjeve kapitale të përmendura në nenin 2, të këtij vendimi do të bëhet nga mbetjet e mjeteve kapitale pas lidhjes së kontratave si vijon. Drejtoria për Infrastruktura Lokale (660), nën-programi (66310), kodi funksional 0620 rialokimin e mjeteve do t'a shpenzojë në këto mbetjet e projekteve kapitale :

ARSYETIM

Kërkesa për ridestinimin e mjeteve financiare në kategorinë ekonomike të shpenzimeve Shpenzime kapitale brenda programit të Drejtorisë për Infrastruktura Lokale, bëhet me qëllim që të sigurohen mjetet financiare për projektet;

Propozimi për marrjen e vendimit nga ana e Kuvendit të Komunes lidhur me ridestinimin e mjeteve financiare mbrenda programit të Drejtorisë për Infrastruktura Lokale në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale për vitin fiskal 2022 është tejet e arsyeshme nga projektet kapitale në të cilat kemi mbetje të mjeteve financiare dhe këto mbetje të përdoren për projektet e lartecekura.

Qëllimi i këtyre ridestimeve është realizimi i projekteve që janë në listën e projekteve kapitale por që kemi mungesë të mjeteve buxhetore, dhe orientimi i këtyre mjeteve në këto projekte do të ndikojnë në realizimin e projekteve kapitale.

Drejtoria për Infrastruktura Lokale

Kryetari i Komunes
Ramiz Lladrovci



REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Data		15/07/2022	
Nj. Org	Numer	Shifra	Vlera
21	400/01-	35903	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit



Opština Gllogovc / Municipality of Drenas / Gllogovc
Zyra e Kryetarit/ Kancelarija gradonačelnika/ Office of the Mayor

DRAFT RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË KOMUNËN E DRENASIT

Korrik, 2022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), nenit 34.6 nën-pika f të Statutit të Komunës së Glllogocit të aprovuar në vitin 2008, dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2022, të aprovoi këtë:

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim që të rregullojë organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet në territorin e Komunës së Drenasit, themelimin e këshillave të bashkësive vendore, kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre, duke i siguruar banorët e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në realizimin e të drejtave, interesave dhe obligimeve të tyre, në shumë fusha të jetës dhe paraqitjes së organizuar para Komunës dhe organeve të saj.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo Rregullore rregullon mënyrën e organizimit, funksionimit dhe bashkëpunimit mes komunës dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane duke formuar këshillat lokale si trupa mbështetës të organeve të komunës që ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

Neni 3

Numri i fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës

1. Në Komunën e Drenasit vetëqeverisja lokale ushtrohet në nivel të bashkësive vendore: në qytet si lagje urbane dhe në fshatra, si fshatra ose vendbanime, në përputhje me dispozitat ligjore dhe statutare.
2. Në pamundësi që në çdo fshat, vendbanim ose lagje urbane të zgjidhet këshilli lokal, atëherë një këshill mund të përfshijë një e me tepër fshatra, vendbanime apo lagje urbane.
3. Komuna e Drenasit në përputhje me UA (MAPL) 02/2019, Neni 4, paragrafi 2.5, themelon 25 këshilla lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe ato janë:

1	Abria e Epërme	Abria e Epërme
		Tërdevci

2	Arllat	Arllati
		Gjergjaj
		Bytyq
3	Baicë	Baica
4	Drenasi I	Drenasi I
	Drenasi II	Drenasi II
		Lagjja e Feronikelit
5	Çikatovë e Re	Drenasi III
6	Dobroshevc	Dobroshevc
		Çikatovë e Vjetër
		Godanc
7	Gllobar	Gllobari
8	Gllanasellë	Gllanasella
9	Gradicë	Gradica
		Likoshani
10	Kizharekë	Kizhareka
11	Komorani I	Komorani I
		Komorani II
12	Komorani II	Komorani III
		Komorani IV
13	Korroticë e Epërme	Korrotica e Epërme
		Zabeli i Epërm
14	Korroticë e Poshtme	Korrotica e Poshtme
		Zabeli i Poshtëm
15	Krajkovë	Krajkova
		Domaneku
16	Llapushnik	Llapushniku
17	Negroc	Negroc
		Vuçaku
18	Nekoc	Nekoci
19	Poklek	Pokleku i Vjetër
		Poklek i Ri
		Vasileva
20	Polluzhë	Polluzha
21	Sankoci	Sankoci
		Fushtica e Epërme
		Fushtica e Poshtme
22	Shtrubullovë	Shtrubullova
23	Tërstenik	Tërsteniku I
		Tërsteniku II
24	Vërboc	Vërboci
		Shtutica

Neni 4

Formimi i Komisioneve nga Kuvendi i Komunës për zgjedhjen e këshillave lokale

1. Kuvendi i Komunës emëron një Komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në terren në zgjedhjen e këshillave lokale. Kuvendi i Komunës emëron një komision prej 7 anëtarëve në përbërje: 4 (katër) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme

politike, 1 (një) nga ekzekutivi, 1 (një) anëtar nga shoqëria civile dhe 1 (një) nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që përcaktohet aty për aty nga tubimi dhe i cili njëkohësisht është bashkëkryesues i tubimit.

2. Komisioni duhet të reflektojë përfaqësimin gjinor (dhe etnik nëse aplikohet). Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Kryesuesi i komisionit zgjidhet me shumicë votash të anëtarëve prezent në mbledhje.

Neni 5

Përgjegjësitë e Komisionit të Kuvendit të Komunës

1. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës duhet të jetë përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së tubimeve me qytetarë, për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

2. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, nëpërmjet Zyrës për informim, informon qytetarët 7 ditë para datës së mbajtjes së tubimit me qytetarë për zgjedhjen e këshillave lokale përmes:

2.1 Shpalljeve publike, të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet ku do të zgjidhen këshillat lokale;

2.2 Mediave lokale;

2.3 Ueb-faqes zyrtare të komunës; dhe

2.4 Rrjeteve sociale.

3. Njoftimi publik domosdo duhet të përmbajë:

3.1 Rendin e ditës;

3.2 Datën;

3.3 Kohën dhe

3.4 Vendin e mbajtjes së tubimit.

4. Komisioni i raporton Kuvendit të Komunës për procesin zgjedhor.

5. Mandati i Komisionit përfundon me mandatin e Kuvendit të Komunës.

Neni 6

Formimi i këshillave lokale

1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane do të ketë tre (3) deri shtatë (7) anëtarë, varësisht nga numri i banorëve. Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshill, përcaktohet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë prezent në tubimin zgjedhor.

2. Këshilli duhet të përfshijë përfaqësimin e çdo Fshati, Vendbanimi apo Lagje urbane, Përbërja e këshillit lokal duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore. Në rast se në Fshat, Vendbanim apo Lagje urbane jetojnë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, nëse marrin pjesë në tubimin zgjedhor ata duhet të jene të përfaqësuar në këshillin lokal.
3. Zgjedhja behet përmes votimit të fshehte në tubimin me qytetarë, përveç nëse tubimi vendose ndryshe. Të drejtë vote kanë të gjithë banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjeve urbane përkatëse mbi moshën 18 vjeçare.
4. Kandidatët për kryetarë dhe anëtarë të këshillave lokale duhet të jene banorë të përhershëm në atë lokalitet.
5. Tubimin publik e hap Kryetari apo njeri nga anëtarët e Komisionit të Kuvendit të Komunës që e ndihmon në bashke kryesim përfaqësuesi i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që përcaktohet aty për aty, i cili njëkohësisht është edhe anëtar i Komisionit të Kuvendit të Komunës.
6. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane zgjidhet me mandat 4 vjeçar.

Neni 7 **Kriteret e përzgjedhjes për këshilla lokale**

1. Kandidatët për pozita të anëtarëve të Këshillit lokal duhet të kenë mbushur 18 vjet në ditën e organizimit të zgjedhjeve për themelimin e këshillave lokale, të jene banues të atij fshati, vendbanimi apo lagjeje urbane, si dhe të gëzojnë integritet të larte moral dhe të kenë reputacion të mire në komunitetin e tyre.
2. Kandidatët për pozite të kryetarit të Këshillit lokal, nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur apo të emëruar në poste udhëheqëse në strukturat e subjekteve/partive politike.
3. Për anëtarë të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane, zgjidhen kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane me të drejtë vote që janë prezent në tubimin zgjedhor, dhe me atë rast duhet të respektohet përfaqësimi gjinor/etnik në strukturën e këshillit. Në rast se dy ose më shumë kandidatë kanë vota të barabarta, atëherë zhvillohet raundi i dytë i votimit. Kandidati që fiton shumicën e votave zgjidhet anëtar.
4. Për anëtar të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, nuk lejohet të jene më shumë se një anëtar i familjes së ngushtë.
5. Kryetari i Këshillit lokal është njëkohësisht edhe anëtar i Këshillit lokal.
6. Tubimet zgjedhore kanë legalitet dhe legjitimitet juridik, nëse në tubime janë të pranishëm si në vijim:

6.1 Në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane ku numri i banorëve është deri 100, pjesëmarrja duhet të jetë së paku 11 banorë;

6.2 Në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane ku numri i banorëve është nga 100 deri 300, pjesëmarrja duhet të jetë së paku 21 banorë;

6.3 Në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane ku numri i banorëve është nga 300 deri 500, pjesëmarrja duhet të jetë së paku 31 banorë;

6.4 Në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane ku numri i banorëve është mbi 500, pjesëmarrja duhet të jetë së paku 41 banorë.

Neni 8

Ndërprerja dhe pushimi i mandatit të anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale

1. Në rastet kur qytetarët konsiderojnë që ndonjë nga anëtarët ose Kryetari i këshillit lokal nuk i kanë përmbushur obligimet që dalin nga kjo Rregullore, anëtari dhe Kryetari i këshillit lokal mund të shkarkohen me shumicë (50 % plus 1 votë) të votave të banorëve me të drejtë votë të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.

Në mënyrë që të behet ky votim, kërkohet një peticion për ndërprerjen e mandatit që duhet të nënshkruhet nga banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Ky peticion duhet të mbledhë nënshkrimet e më shumë së gjysmës së numrit të pjesëmarrësve nga takimi ku është zgjedhur këshilli lokal. Komuna, respektivisht Komisioni Komunal duhet të lajmërohet paraprakisht për një mbledhje të tille.

2. Në rastet kur këshilli lokal shkarkohet si tërësi (anëtarët e këshillit dhe kryetari), një votim i ri duhet menjëherë të bëhet në bazë të procedurave të nenit 6 dhe 7 të kësaj Rregulloreje në mënyrë që të zgjidhet këshilli i ri lokal dhe kryetari.

Neni 9

Përfundimi i mandatit dhe zëvendësimi i anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale

1. Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokale përfundon:

1.1 Me përfundim të mandatit;

1.2 Nëse jep dorëheqje;

1.3 Nëse ndërron vendbanimin;

1.4 Nëse shkarkohet;

1.5 Në rast se dënohet për vepër penale me një urdhër për burgim prej 6 muaj ose më tepër,

1.6 Nëse përfshihet në strukturat udhëheqëse të subjekteve/partive politike; dhe

1.7 Nëse vdes.

2. Në rast të humbjes së mandatit të Kryetarit të këshillit, komisioni komunal brenda tridhjetë (30) ditësh duhet të organizoj zgjedhjet për zgjedhjen e Kryetarit të ri.

3. Zëvendësimi i anëtarëve të këshillave lokale në rastin e humbjes së mandatit apo zgjedhjes së tij kryetar i këshillit sipas paragrafit 2 të këtij neni, bëhet nga lista e pritjes me aprovimin e Komisionit të Kuvendit të Komunës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh. Ndryshmet në përbërje

të këshillave lokal duhet të publikohen në ueb faqen e komunës pas miratimit të vendimit nga Kuvendi i Komunës.

Neni 10

Mbajtja e procesverbaleve në tubimet me qytetarë

1. Në të gjitha tubimet me qytetarë, në lidhje me zgjedhjen e shkarkimin e këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave mbahet procesverbali.
2. Procesverbali nga tubimi me qytetarë përmban: emrat dhe mbiemrat e anëtarëve të Komisionit Komunal që udhëheqin dhe koordinojnë punën në terren për zgjedhjen e këshillave lokal, zyrtareve komunale, listën e pjesëmarrësve (qytetarëve) që kanë marrë pjesë në tubim duke përfshirë emrin, mbiemrin, numrin e letërnjoftimit, të dhënat për zgjedhjen e këshillit lokal duhet përfshirë emrat e kandidatëve, të dhënat për shkarkimin e këshillit lokal, procedurat e votimit, duke përfshirë emrat e kandidatëve dhe numrin e votave të mbledhura dhe çështjet tjera të nevojshme që duhet të shënohen në procesverbal.
3. Procesverbalin e mban një anëtarë i Komisionit Komunal i cili organizon tubimin. Procesverbalin e nënshkruan kryesuesi i tubimit dhe procesmbajtësi, ndërsa komisioni sipas nenit 3 të kësaj Rregulloreje, i raporton Kuvendit të Komunës për rrjedhën e tubimeve për zgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Procesverbali me të gjitha të dhënat e përmendura në paragrafin 3, të këtij neni, publikohet në ueb faqen e komunës menjëherë pas tubimit zgjedhor.

Neni 11

Konsultimet ndërmjet komunës dhe këshillave lokale

1. Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës ftojnë përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, që të marrin pjesë në tubimet publike me qytetarë, në dëgjimet publike për buxhet dhe aktet legjislative, tubimet e rregullta publike, takimet për planifikim strategjik që organizohen nga komuna përkatësisht Kuvendi i Komunës ose Kryetari.
2. Së paku kryetari ose një anëtar i këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane duhet të jetë i përfshirë në të gjitha grupet punuese komunale për hartimin e hartave zonale dhe planeve zhvillimore dhe rurale që janë pjesë e lokalitetit ku ata jetojnë.
3. Kryetari i Komunës duhet që së paku të organizojë dy takime në vit me udhëheqësit e këshillave lokale. Takimet duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj. Për rendin e ditës duhet të konsultohen edhe udhëheqësit e këshillave lokale.
4. Kuvendi i Komunës mund të kërkojë një opinion nga këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, në çështje të caktuara me interes për komunitetin.

Neni 12

Bartja e aktiviteteve nga komuna të këshillat lokale

1. Me kërkesën e këshillit lokal dhe propozimin e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës me vendim mund të bartë disa detyra dhe përgjegjësi për t'i ushtruar këshillat lokale të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane. Aktivitetet që mund të transferohen duhet të jenë në kompetencë ekskluzive vetanake të komunës.
2. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane duhet të konsultohet dhe pranojë bartjen e aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal.
3. Në rast të bartjes së aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal, komuna ofron mbështetje dhe burime të mjaftueshme për këshillat e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisë të bartura.
4. Marrëveshjet që lidhen në mes komunës dhe këshillave lokale duhet të miratohen nga Drejtoria përkatëse në komune.

Neni 13

Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillave lokale

1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane duhet të takohet së paku 6 (gjashtë) herë brenda vitit për të shqyrtuar çështjet në interes të lokalitetit, si dhe harton dhe miraton planin e punës së këshillit dhe rregullat e brendshme të funksionimit.
2. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, organizon, përcjell dhe planifikon planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit, në të gjitha sferat në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, Kryetarin e Komunës, komitetet dhe drejtoritë komunale.
3. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane duhet të informojë komunën për kohen dhe agjendën e takimeve. Zyrtaret komunal nga fushat përkatëse mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat lokale. Takimet e qytetarëve mund të organizohen me iniciativën e këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.
4. Këshilli lokal mund të ndër marrë aktivitete të cilat në veçanti ndikojnë në:
 - 4.1 Zhvillimin lokal ekonomik të qëndrueshëm të lokalitetit;
 - 4.2 Planifikimin urban dhe rural të lokalitetit;
 - 4.3 Mbrojtjen e mjedisit lokal të lokalitetit;
 - 4.4 Ndihmon në rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike komunale brenda lokalitetit;
 - 4.5 Siguron të dhënat elementare për çdo familje të lokalitetit përkatës, përcjell gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe jep rekomandime, propozime për mbështetje të këtyre rasteve;
 - 4.6 Ndihmon në mirëmbajtjen e varrezave dhe hapësirave publike të gjelbëruara;

4.7 Zhvillimin e turizmit;

4.8 Organizimin e aktiviteteve kulturore e sportive;

4.9 Bashkëpunimin me organet e komunës dhe organizata të tjera të shoqërisë civile për çështjet me interes për lokalitetin;

4.10 Organizimin e aksioneve vullnetare në interes për lokalitetin; dhe

4.11 Zbaton aktivitetet që janë të bartura, sipas procedurave në nenin 12 të kësaj Rregulloreje.

5. Këshillat lokale mund t'i parashtrojnë Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit pyetje me shkrim për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit, dhe brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh organet e komunës duhet t'i përgjigjen këshillit lokal.

Neni 14

Roli i kryetarëve të këshillave lokale

1. Kryetari/ja i/e këshillit lokal përfaqëson fshatin, vendbanimin apo lagjen urbane në konsultimet dhe diskutimet me Kuvendin e Komunës dhe Kryetarin e komunës.

2. Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq mbledhjet e këshillit lokal dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit lokal. Po ashtu, ai/ajo nënshkruan konkluzionet e takimeve, propozimet dhe prioritetet e miratuara nga ana e këshillit lokal dhe është i obliguar që në afat prej 15 ditëve nga dita e miratimit të tyre t'i dorëzojë të organet komunale, përmes Sekretarisë së Kuvendit.

Neni 15

Financimi i aktiviteteve

1. Financimi i aktiviteteve të këshillave lokale mund të bëhet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, nga komuna, nga financimi i përbashkët si dhe nga donatorët, në pajtueshmëri të plote me Statutin e komunës, Rregulloret komunale dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës për menaxhim të financave publike.

2. Këshilli lokal bën raporte gjashtëmujore dhe vjetore të mjeteve të inkasuara, si dhe atyre të shpenzuara, dhe i bën ato transparente për qytetarët e atij lokaliteti si dhe për Kuvendin e Komunës dhe Kryetarin.

Neni 16

Kompensimi i këshillave lokale

1. Për punën e tyre kryetarët e këshillave lokale kompensohen nga buxheti i komunës.

2. Kompensimi për kryetarët e këshillave lokale duhet të jetë ekuivalent me shumën e kompensimit të anëtarëve të komiteteve obligative.

3. Kompensimi për pjesëmarrje në takime behet vetëm për 6 takime të këshillave lokale të mbajtura gjatë vitit kalendarik.

4. Kompensimi nënkupton që mjetet financiare të shfrytëzohen vetëm për nevoja të funksionimit të këshillit lokal.

Neni 17

Mos përmbushja e përgjegjësi

Për të gjitha aktivitetet e bartura në këshillin lokal nga organet e komunës, këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane përkatëse mbanë obligime dhe përgjegjësi ligjore.

II. DISPOZITAT KALIMTARE, SHFUQIZUESE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 18

Në rast konflikti të dispozitave të kësaj Rregulloreje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës, mbizotërojnë dispozitat e ligjit dhe statutit.

Neni 19

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë Rregullore do të bëhen sipas procedurës së njëjtë të aprovimit të kësaj Rregulloreje.

Neni 20

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja me nr. Protokolli 12-Nr. 16-17684, datë 27.12.2012, për organizimin, bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në Komunën e Drenasit.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Drenasit.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GILLOCOG			
GILLOCOG MUNICIPALITY			
Numri	7/1	07	202
Ni Ora	Numër	Sh. S. J	Vlera
01	052/03	35593	

Raporti i konsultimit publik për draft-rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagjet urbane



Konsultimi publik për draft-rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagjet urbane



Të premtën më 17 qershor në Sallën e Kuvendit është mbajtur konsultimi publik për të diskutuar draft-rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe lagjet urbane në Komunën e Drenasit.



Nënkryetari Shala - Të nderuar administratorë, faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim konsultativ lidhur me draft dokumentin për rregulloren e Këshillave Lokale.

Në vitin 2019 është miratuar një udhëzim administrativ për bashkëpunimin në mes lagjeve dhe bashkësive lokale. Në këtë udhëzim administrativ përcaktohet edhe numri i këshillave lokale në **nenin 4 që parashihet prej 50 mijë e një banorë deri në 70 mijë banorë Komuna duhet të ketë 25 këshilla**. Ne i kemi hartu një propozim ku i kemi propozuar 25 këshilla. Pak a shumë e kemi shikuar propozimin tonë, mund të ketë pakënaqësi, mënyra e përzgjedhjes është bërë edhe territorialisht por megjithatë nuk kemi kaluar mbi 2-3 fshatra. Këtu specifikohet edhe zgjedhja e këshillave lokale por e lë për më vonë se nuk është e rëndësishme tani.

Me këtë udhëzim administrativ rregullohet edhe kompenzimi për administratorët që ka qenë shumë e nevojshme, mbi bazën e shumës ekuivalente të komiteteve obligative. **Deri në 6 mbledhje sikur në KKSb.**

Në rregullore parashihen të gjitha detajet, formimi i komisioneve, përgjegjësitë, mënyren sesi përbëhen, kriteret e përzgjedhjes, përfundimi i mandateve dhe zëvendësimi bartja e aktiviteteve nga Komuna deri tek këshillet lokale etj.



Bekim Dobra - E tha edhe nënkryetari që ky dokument i paraprinë edhe zgjedhjes së Këshillit të fshatrave, përbehen prej shtatë anëtarëve. Pasi janë bërë fuzionimet e fshatrave 2-3 fshatra në një vendbanim dhe me i zgjedhë dy tri fshatrat një kryetar të këshillit. Ato janë periudha tjera që bëhen me kohë.

Ne jemi sot në këtë takim për me u konsultu për këtë draft dokument edhe me juve.



Albert Nika (administrator i fshatit Gllanasellë) - Përsëritje të ndëruar të pranishëm, e falenderojë nënkryetarin Shala për bashkëpunimin sidomos në kohën e pandemisë ku keni qenë gjithmonë aktiv në mbështetje të tonë.

Administratorët e fshatrave të Komunës së Drenasit kanë qenë të diskriminuar sepse ju ka mohu e drejta e kompenzimit minimal që ju ka taku. Kemi pasur një rregullore mirëpo kjo nuk është zbatuar. Kanë përgjegjësi të madhe administratorët në fshat sepse kanë të bëjnë me çështje të ndjeshme me shtresat e varfëra që në shumicë janë edhe të paarsimuar. Administratorët duhet të mbrohen me një nen sepse kur kemi të bëjmë tek shpërndarja e ndihmave kemi të bëjmë me familje që janë të paarsimuara dhe po nënshkruajnë për kushërinjtë dhe jo familjarët e afërt. Unë jam dënuar për këso raste dhe gjykatësi më ka thënë "hajt se nuk u bë nami që je denu se për të mirën e fshatit tënd je denu".

Sa i përket rregullores së re, tek përfundimi i mandateve neni 9 paragrafi 1.6 nëse përfshihet në struktura udhëheqëse të partive politike, për arsye që administratori i merr vetëm 300 euro në vit, sikur administratori të merrte një pagë të dinjitetshme atëherë kishin me qenë shumë e mirë si praktikë por me 300 euro në vit është shumë e palogjikshme, pikën 1.6 me analizë pak dhe një nen për mbrojtje të administratorëve. 15 familje i kam që nuk dijnë shkrim dhe lexim ata vec duhet me dhanë gisht, çfarë të bëjmë me ta, përse me u denu administratori për shkak të këtyre faktorëve?

Administratorin e fshatit Komuna e ka obligim moral që kur të realizohet ndonjë projekt të njoftohen administratorët dhe për detajet e projekteve.

Unë në Gllanasellë kam pasur shumë probleme, nuk e di ku ka rrugë 3.80 metra, kam parë 5 metra, 4 metra por jo 3.80 metra. Kështu duhet me i pas informatat administrator për këto projekte sesi zhvillohen sepse sot jam unë njeri tjetër, pasneser tjetër etj.

Sot jam ardhur me të falenderu nënkryetar për bashkëpunimin e shkëlqyer që e kemi pasur ne.

Arben Shala (nënkryetar i Komunës) - Faleminderit shumë për falenderime, ato ju takojnë juve sepse ju keni qenë në terren dhe e keni pasur më vështirë, faleminderit të gjithëve për kontributin tuaj. Sa i përketë bashkëpunimit paraparak nuk di çfarë të them, as për rregulloren e vjetër për kompenzim.

Tek mbrojtja e nënshkrimeve duhet me pa a kemi mundësi a jo. Për projekte kam marr hapa që ju me u njoftu për secilën projekt është një kompenzim moral që e kemi ndaj juve. Kur kemi dëgjime buxhetore me na njoftu për projektet të ndryshme sepse edhe kryetari ka kërku në vazhdimësi me qenë më vigjilent.

Samedin Kicina (administrator i fshatit Baicë) - Përsëndetje për të gjithë, deshta me u nderlidhë me kolegën se krejt çfarë tha ashtu është. Krejt punimet që po bëhen po e dijme sesi funksionojnë, kush i ka lidhjet, trotuari në Baicë me riparuar, është për keqardhje është tmerr.

Ndërhynë nënkryetari Shala - I nderuar sot kemi diskutim për rregulloren.

Samedin Kicina - Nuk jam i interesum për rregullore i tha kolega paraparak, unë shqetësimet e mija i ngrita, më vjen keq vec shumë shumë keq


Enver Hoxha - Përsëndetje për të gjithë, unë e kam një vërejtje tek përfaqësimi, është shumë e keqe metoda, është problem me zgjedh përfaqësimi në këtë mënyrë.

Problem është me u zgjidh ky përfaqësimi i dy tri fshatrave me një përfaqësues, tash me shku qytetari me shku në Krikovë, ose me shku në Damanek për një kërkesë të thjeshtë, për kanalizim. Qytetari me shku prej Damaneku, me lyp Enverin se ju ka mbyllë një kanalizim ose ka nevojë për rrugë, është shumë e pakuptimtë.

Arben Shala - I nderuar këtë udhëzim e ka bërë ministria, ata e kanë paraparë këtë formë të funksionimit, ne duhet me ju përmbajt këtëre parametrave që ata i kanë caktu. Kanë thënë 25 duhet me ju përmbajtë atij numri.

Bekim Dobra - Për ata mbahen zgjedhjet për me zgjedh një përfaqësues dinjitoz. Edhe nuk është e thënë që për një kanalizim me marr konfirmimin e administratorit.

Ata mund të vijnë edhe vet të bëjnë kërkesën e protokoluar. Ai përfaqësues nuk është i vetëm e ka Këshillin që ka me u konsultu. Në këtë rregullore mundemi me çu me kërkesën tuaj në 44 administratore, por nuk kemi me marr ligjshmëri nga ministria.



Kadri Ajazi (përfaqësues i fshatit Sankoc) - Është problem kjo punë se fuzionimi është i vështirë se ka kërkesa të shumta dhe poqëse bëhet bashkëpunimi atëherë ka me pasur ngecje të mëdha. Unë kam punuar shumë për përfaqësimin e denjë të kërkesave të fshatit por që ka qenë shumë e vështirë. Ne vërejtjet po i japim, ju duhet me i çu atje tek vendi se po frikësohemi që nuk ka me pasur bashkëpunim.

Bekim Dobra - Kemi me shqyrtu një mundësi për me ju stimulu me numra me pas një mbushje për shkak të komunikimit që keni me Komunë dhe me banorë, por ajo është fazë tjetër.

Avdyl Mziu (banor i Komoranit) - Përsëndetje për të gjithë, deshta me bë një kërkesë dhe propozim lidhur me këtë draft listën për numër të administratorëve nëpër vendbanime, varësisht prej numrit të popullsisë që është faktori kryesor, *nëse merret për bazë numri i përgjithshëm i banorëve të Komunës së Drenasit afërsisht 59 mijë e dicka banorë pjestu për 25 administrator po i bjen që duhet me pas administratorë çdo 2 mijë e 360 banorë.*

Komorani i ka afërsisht 5 mijë, po besojë që është i nevojshëm me ju shtu edhe një administrator njëjtë qysh ju ka shtu edhe Drenasit sepse edhe Drenasi ka nevojë për përfaqësim më të madh.

Nuk mundet me i përfaqësu kërkesat e 5 mijë banorëve edhe nuk është e drejtë me një administrator sepse ka vendbanime që janë të vogla edhe me numër të banorëve edhe me territor që e kanë një administrator njëjtë sikurse Komorani.

Deshta me bë propozim që me u rritë numri i administratorëve e ndonjë fshat tjetër që ka shumë më pak banorë me u bashku me ndonjë fshat tjetër që ka pak banorë.

Albert Nika (administrator i fshatit Gllanasellë) - Tek neni 7 kriteret për zgjedhjen e këshillave të fshatrave duhet me marrë pjesë 41 banorë për me u zgjedhë, e cka nëse 3 herë dështon mbledhja edhe s'bëhet korumi?


Edhe pyetja e dytë, a ka mundësi ligjore për administratorët që kanë qenë për katër vite me ju dhënë ndonjë dokument që dëshmon se ka qenë kryetar fshati dhe që ka punuar. Ndonjë vërtetim, mirënjohje diçka kësisoji?

Bekim Dobra - Albert në këtë udhëzim administrativ që e kemi marrë prej ministrisë rregullohet, neni 7 pika 6.4 është precizu në këtë draft, por megjithatë do të diskutohet kur të krijohen këshillat e fshatrave.

Tek propozimi i dytë, puna vullnetare në shtetet e perendimet ka vlerë të madhe dhe me pas një dokument të tillë ka përparësi të mëdha në punësim. Ju falenderojë shumë për pjesëmarrje dhe për bashkëpunimin tuaj për këto katër vite.

Përfaqësuesi i fshatit Poklek - Unë e kam një vërejtje lidhur me emërtimin "**Poklek i Ri**" - "**Poklek i Vjetër**", nuk janë as njëra as tjetra, është vec një Poklek. Ti nënkryetar je një njeri i mrekullueshëm na u ke gjindë në ditët më të vështira.

Kam vërejtje se përse nuk po konsultoheni me neve si administratorë për projektet që po zhvillohen në vendbanimet tona.



Raporti i konsultimit publik për draft-rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime dhe lagjet urbane

Ramiz Lladrovci

Kryetar i Komunës së Drenasit

Shyqiri Bublaku

Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

Avdyli Mziu

Zëdhënës i Komunës



Drenas,

17.06.2022



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit



Nr.01-400/11-36502, dt. 18/07/2022

Në mëshetje të nenit 15, pikë 10 të ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Kryetari i Komunës nxjerr:

PROPOZIM – VENDIM
BARTAJA E MJEVEVE FINANCIARE NGA KATEGORIA REZERVA

Neni 1

Me këtë Propozim Vendim, mjetet nga kategoria Rezerva në shumën e gjithëmbarshme 210,346.00 euro bartën në kategori tjera ekonomike.

Neni 2

Mjetet e kategorisë Rezerva sipas nen-programeve:

Nen-programi Infrastruktura Rrugore(18001),burimi i financimit (10) shuma prej	32,100.00 €
Nen-programi Infrastruktura Rrugore(18001),burimi i financimit (21) shuma prej	40,000.00 €
Nen-programi Infrastruktura Publike(18161),burimi i financimit (10) shuma prej	108,246.00 €
Nen-programi Administrata-Arsim(92005), burimi i financimit(21) shuma prej	25,000.00 €
Nen-programi Planifikimi Urban dhe Inspeksioni(66310),burimi i financimit(21) shuma prej.....	5,000.00 €

Bartën në:

➤ **Nen-programin Infrastruktura Publike(18161);**

Projekti (48626),Ndërtimi i infrastrukturës(Asfaltimi dhe kubzimi)Drenas I,II,III dhe IV në shumën prej.....	46,328.29 €
Projekti (48661) Ndërtimi i kapacitetit të ujësjes në Drenas(48661) në shumën prej.....	50,000.00 €
Projekti (48693) Kanalizimi i ujërave të zeza dhe atmosferike në Drenas I,II,III dhe IV në shumën prej.....	2,142.43 €

➤ **Nen-programi Arsimit fillor,i mesëm i ulët (93000);**

Në kategorinë e shpenzimeve Paga dhe Shtesa (11) në shumën prej.....111,875.28 €

Neni 3

Për zbatimin e këtijë vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa

KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Iladrovci



A r s y e t i m

Bartja e mjeteve nga kategoria Rezerva në nen-programet Infrastruktura Publike dhe Arsim fillor bëhë me qëllim të plotësimit të buxhetit për projektet kapitale dhe kategorisë së paga dhe shtesa të cilat janë ndikuar negativisht nga vendimet e formës së prerë nga autoritetet përmbarimore.